



Titulli i projektit

Krijimi i shoqatave të prodhuesve të produkteve frutore: Rrush, Gështenja, Mollë, Dardhë, etj. (Bashkia Klos dhe Mat)

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik nëpërmjet zgjerimit të të ardhurave nga produktet vendore

Vendndodhja e projektit

Të gjitha komunat gjatë Luginës së Matit

Buxheti i paravlerësuar

600,000,000 Lekë

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Lugina e Matit ka kushte të favorshme për kultivimin e shumë drurëve frutorë dhe sidomos rrushit. Disa nga varietetet lokale janë të njohura në Mat dhe më tej (Tajga e Bardhë, e Kuqe, Cërruja, etj). Megjithatë, përfitimet nga prodhimi dhe tregtimi i këtyre produkteve mbeten të kufizuara. Shkak për këtë është aftësia e ulët për investime në teknologjitë e prodhimit dhe të përpunimit, e lidhur direkt me madhësinë e kufizuar të fermave bujqësore dhe blektorale. Nxitja e formave të bashkëpunimit nëpërmjet krijimit të shoqatave të prodhuesve, ose përpunuesve, me status juridik, do të rriste aftësinë kredimarrëse dhe përfitimet nga ekonomitë e shkallës.

Qëllimi/et specifik të projektit

Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, duke shfrytëzuar avantazhet krahasuese dhe konkurruese vendore.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Krijimi i shoqatave të prodhuesve dhe përpunuesve të drurëve frutorë me status juridik: (të paktën 5 shoqata të krijuara me anëtare me kontribute në asete, ose kuotë anëtarësie, me borde dhe llogari bankare dhe aftësi për të hyrë në transaksione financiare me të tretë, në dobi të anëtarëve të saj).
- Rritje e volumeve të shitjeve dhe e të ardhurave për fermerët vendas nga tregtimi i produkteve vendore në tregun lokal, rajonal dhe kombëtar (volumet e shitjeve dhe të të ardhurave në shkallë vendore më të larta se në tre vitet e fundit, para krijimit të këtyre shoqatave).
- Investimi në pika grumbullimi dhe në pajisje frigoriferike (çdo shoqatë në fund të periudhës trevjeçare të aktivitetit të ketë në pronësi të paktën një ngrehinë grumbullimi dhe magazinimi frigoriferik të produktit përkatës).
- Zhvillimi i markave lokale të regjistruara të produkteve vendore (secila nga shoqatat të ketë markën e vet të produktit përkatës).
- Lidhja me institutet rajonale dhe kombëtare të bujqësisë për mbështetjen me programe formimesh në teknologji dhe metodat moderne të përpunimit, në përputhje me kushtet klimatike të zonës (lidhje dhe memorandumet e bashkëpunimit të nënshkuara me Institutin e Bujqësisë BIO, të rrushit dhe të fidanëve, Universitetin e Kamzës, etj.).



Aktivitetet e projektit

- Krijimi i shoqatave dhe vënia në veprim e tyre me një status juridik (bord, statut, administratë, seli dhe logari bankare në bazë të legjislacionit shqiptar).
- Fillimi dhe zgjerimi i aktivitetit të ndërmjetësimit të kontratave të shitblerjes, apo të përpunimit të produkteve bujqësore me të tretë në tregje lokale, rajonale, kombëtare apo ndërkombëtare. Krijimi i portaleve on line/telefonikë të tregimit të këtyre produkteve.
- Zgjerimi i aseteve të shoqatave nëpërmjet kontributeve në pjesë, kuota nga anëtarët kundrejt pjesëmarrjes në fitime, apo nëpërmjet financimit me kredi me kushte lehtësuese, të paguara me normat e fitimeve nga aktiviteti.
- Krijimi i markave lokale të produktit vendor dhe i sistemit të certifikimit të këtyre markave nga shoqata përkatëse.
- Trajnimi i fermerëve në metoda moderne të rritjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore, gjithmonë në respekt të ambientit dhe traditave vendore.
- Aktivitete promovionale dhe informuese për të rritur shkallën e pjesëmarrjes dhe anëtarësisë në këto shoqata.

Maturimi i projektit

Nuk ka një koncept fillestar dhe fazë paraprake të këtij projekti.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e Financimit:

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve;
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
- Të ardhurat e veta nga kuotat e anëtarësisë ose asetet e pjesëmarrësve në shoqatë;
- Donatorët;
- Bankat dhe institucionet financiare.

Partnerët:

- Bashkia Mat dhe Klos;
- Ministria e Bujqësisë, drejtoritë rajonale të bujqësisë, institucionet e varësisë;
- Donatorë: BE, BB, USAID, GIZ;
- Banka: BERZH, ProCredit, Institutet e Mikrofinancës.

Kostot e projektit

Krijimi i shoqatave dhe vënia në veprim e tyre 20,000,000

Fillimi dhe zgjerimi i aktivitetit të ndërmjetësimit të kontratave të shitblerjes, apo të përpunimit të produkteve bujqësore me të tretë në tregje lokale, rajonale, kombëtare apo ndërkombëtare. Krijimi i portaleve on line/telefonikë të tregimit të këtyre produkteve 0

Zgjerimi i aseteve të shoqatave nëpërmjet kontributeve në pjesë, kuota nga anëtarët kundrejt pjesëmarrjes në fitime, apo nëpërmjet financimit me kredi me kushte lehtësuese, të paguara me normat e fitimeve nga aktiviteti 570,000,000

Krijimi i markave lokale të produktit vendor dhe i sistemit të certifikimit të këtyre markave nga shoqata përkatëse 10,000,000

Trajnimi i fermerëve në metoda moderne të rritjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore, gjithmonë në respekt të ambientit dhe traditave vendore.

Aktivitete promovionale dhe informuese për të rritur shkallën e pjesëmarrjes dhe anëtarësisë në këto shoqata 0 (të përfshira në shpenzimet e veprimtarisë së shoqatave)

Total: 600,000,000